



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranuar / Dorezuar Prinjenor/Prodato Received/Delivered	30.06.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedimica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojka Prillog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKANSHICK	4975/2023		115



Republika e Kosovës

Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.766 /2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Eshref Shabani dhe Malsore Gashi Bajraktari-anëtarë, me Ardita Perçuku-Shyti-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën A.nr.766/2023 të datës 22.05.2023 të parashtruar nga ankuesi _____ nga _____ kundër organit të punësimit Inspektorati i Punës, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 30.06.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.766/2023 e datës 22.05.2023, e parashtruar nga ankuesi _____

II. Mbetet në fuqi Vendimi me Nr.Prot.1021 i datës 19.04.2023 i Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë si dhe Njoftimi me Nr.Prot.52/2023 i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës.

A r s y e t i m

Ankuesi _____ (tutje vetëm ankuesi) më datë 18.05.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e regjistruar me datë 22.05.2023 nën shenjë A.nr.766/2023, kundër rezultatit përfundimtar të vlerësimit lidhur me pozitën "Udhëheqës i Divizionit të IT-së dhe Shërbime Logjistike" në Inspektoratin e Punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme Këshilli) në pajtim me dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 31.05.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Inspektortai i Punës, ndërsa kjo e fundit më datë 09.06.2023 ka përcjell përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat referuar kësaj çështje juridiko-administrative.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 4364/2023 e datës 22.05.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e ankuesit të datës 13.04.2023 e parashtruar tek Komisioni për Lëvizjen Brenda Kategorisë; Vendimin me Nr.1021 të datës 19.04.2023 të Komisionit për Lëvizje Brenda Kategorisë; E-mailin zyrtar të datës 19.04.2023 lidhur me dëshminë mbi pranimin e vendimit prej KVLB-së për ankuesin; E-mailin zyrtar të datës 03.05.2023 nga Menaxheri i Personelit për ankuesin; E-mailin zyrtar të datës 03.05.2023 nga ankuesi për Menaxherin e Personelit; Kërkesë për përgjigje në ankesë të datës 31.05.2023 nga Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Përgjigjen në ankesë të datës 09.06.2023 nga Inspektorati i Punës së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës; Konkursin me numër të referencës RN00010908 të datës 08.02.2023; Listën e aplikantëve e gjeneruar tek SIMBNJ për aprovim dhe refuzim; Njoftimin me Nr.prot.24/2023 të datës 09.03.2023 lidhur me listën e ngushtë nga NJBNJ; Shkresën zyrtare me Nr.prot.33/2023 të datës 17.03.2023 lidhur me verifikimin paraprak të kandidatëve nga NJBNJ; Renditjen përfundimtare të kandidatëve sipas listës së datës 07.04.2023 e gjeneruar tek SIMBNJ; Pyetjet e intervistës me gojë të datës 07.04.2023 për ankuesin nga anëtarët e komisionit të vlerësimit; Aplikacionin e ankuesit të datës 02.03.2023 së bashku me dëshminë e bashkangjitur të dokumentacionit dhe atë si në vijim: Diplomën me Nr.3544 të datës 27.10.2015 të lëshuar nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"- Fakulteti Juridik; Shkresën zyrtare me numër LRP. Nr.rend.0810/2023 të datës 30.01.2023 nga noteri H.XH.B; Akt emërimit e ankuesit me Nr.Prot.07/2019 të datës 06.06.2019; Akt emërimit e ankuesit me Nr.Prot.85 të datës 26.01.2015; Akt emërimit e ankuesit me Nr.Prot.129 të datës 24.02.2014; Akt emërimit e ankuesit me Nr.Prot.952 të datës 01.11.2012; Vendimin me Nr.1460/2018 të datës 13.12.2018 nga Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës për ankuesin; Formularin për vlerësimin e rezultateve në punë të për ankuesin të datës 28.01.2022 si dhe Njoftimin me Nr.Prot.52/2023 nga Menaxheri i Personelit ne IP; Vendimin me Nr.554 të datës 29.03.2023 për formimin e komisionit për lëvizje brenda kategorisë; Akt emërimit me Nr.38/2021 të datës 10.08.2021 për N.S; Akt emërimit AE.Nr.03/2023 te datës 20.01.2023 për K.M; Akt emërimit e datës 01.11.2022 për A.T; Akt emërimit me Nr.72/2018 te datës 03.12.2018 për K.S; Akt emërimit me Nr.08/2019 te datës 06.06.2019 për V.ZH.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, konstatoi së pretendimet ankimore të ankuesit janë të *pabazuara, sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rrjedhë se Inspektorati i Punës, më datë 08.02.2023 ka publikuar Konkursin për lëvizje brenda kategorisë me numër reference RN00010908, për pozitën e punës *Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative dhe Shërbime Logjistike*, klasa *Drejtues i Ulët 1*, me afat të aplikimit nga data 23.02.2023 deri 02.03.2023. Në këtë konkurs ka aplikuar dhe ankuesi i cili ka marrë pjesë në të gjitha fazat e procedurës, mirëpo që bazuar në vlerësimin e Komisionit për Lëvizje Brenda Kategorisë (tutje KVLBK) i themeluar sipas Vendimit Nr.Prot.850 të datës 28.03.2023, gjegjësisht sipas renditjes përfundimtare të kandidatëve të datës 07.04.2023 i njëjti është vlerësuar me gjithsej 57.6 pikë. Rrjedhimisht Njësia e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës, me Njoftimin Nr.Prot.52/2023 (nuk përmban datë) ka sqaruar se konkursi për lëvizje brenda kategorisë me numër reference RN00010908, për pozitën e punës *Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative dhe Shërbime Logjistike*, ka përfunduar pa kandidat fitues.

Ankuesi brenda afatit ligjor ushtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër kundër rezultatit përfundimtar të vlerësimit lidhur me pozitën "*Udhëheqës i Divizionit të IT-së dhe Shërbime Logjistike*", me pretendimet ankimore se i njëjti nuk është vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe reale nga ana e KVLB-së ngase sipas tij është përgjigjur në të gjitha pyetjet në

mënyrë të saktë, përbërja e anëtarëve të KVLBK-së ka qenë në kundërshtim me dispozitën e nenit 46 paragrafit 2 pika 2.1 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës me arsyetimin se asnjëri nga kandidatët e komisionit nuk kanë qenë të specializuar nga fusha e IT-së apo në shërbime logjistike, i njëjti kërkon nga ana e Këshillit që të rishikoj rezultatin përfundimtar ose të kthej procedurën e konkursit në një pikë zero për pozitën në fjalë si dhe të anulohet ky konkurs në tërësi.

Referuar Konkursit me numër reference RN00010908 si kushte për lëvizjen brenda kategorisë janë përcaktuar: *Të jetë nëpunës civilë i të njëjtës kategori për të cilën aplikon.. Të mos jetë ndëshkuar me ndonjë masë disiplinore që nuk është shuar ende. Të jetë vlerësuar të paktën 'mire' për rezultatet në punë, të paktën gjatë dy viteve të fundit të vlerësimit. Ndërsa si kërkesa të përgjithshme formale janë kërkuar: **Arsimi i kërkuar: Diplomë/ a e arsimit të lartë më së paku 3 vite të studimeve nga fusha: Fakulteti i Teknologjisë Informativë, Ekonomik, Komunikacion Rrugor, Transport dhe Juridik. Kualifikime të posaçme formale: Certifikata, licenca kur kërkohen me legjislacionin në fuqi apo kur vlerësohet se janë të nevojshme për pozitat e kësaj klase. Përvoja e punës së kërkuar: Së paku tri (3) vite përvojë pune. Profesionale.***

Në kuptim të vendosjes meritorë lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit, i'u referua dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkitazi me procedurën e lëvizjes brenda kategorisë, gjegjësisht Kolegji analizo nenin 38 me të cilin është përcaktuar se: *"1. Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë. 2. Nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në kuadër të Shërbimit Civil, që i plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e posaçme për vendin e lirë, mund të aplikojnë për plotësimin e një vendi të lirë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes, sipas paragrafit 1 të këtij neni...:5. Vlerësimi i kandidatëve të interesuar kryhet nga një komision vlerësimi, i krijuar në çdo institucion, bazuar në një intervistë me kandidatët. Komision përbëhet nga pesë anëtarë, njëri nga të cilët është domosdo përfaqësues i Njësisë së Burimeve Njerëzore të institucionit. 6. Në përfundim të vlerësimit, Komisioni mund të vendosë: 6.1. përzgjedhjen e kandidatit më të suksesshëm për t'u emëruar në vendin e lirë, apo; 6.2. përfundimin e procedurës, pa asnjë të përzgjedhur, në rast se asnjë nga kandidatët e interesuar nuk vlerësohet i suksesshëm për atë vend të lirë të punës."*

Po ashtu, Kolegji i Këshillit mori për bazë edhe dispozitat e Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht:

Nenin 44 paragrafit 1 dhe 2, më të cilin është përcaktuar se: *"1.Konkurimi për lëvizjen brenda kategorisë zhvillohet në dy faza: 1.1. verifikimi paraprak i kandidatëve; dhe 1.2. vlerësimi i kandidatëve. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ, ndërsa vlerësimi i kandidatëve kryhet nga Komisioni i Vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë, krijuar sipas nenit 47 të kësaj Rregulloreje"*

Nenin 45 paragrafit 1, 2 dhe 3, me të cilin është përcaktuar se: *"1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurohet. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ. 3.Në përfundim të verifikimit paraprak NJBNJ përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë. Vetëm këta kandidatë kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurimin"*

Nenin 47 paragrafin 1, 2, 3 dhe 4, me të cilin përcaktohet se: *"1.KVLBK zhvillon një intervistë me gojë me kandidatët. 2.Nëpërmjet intervistës, KVLBK vlerëson jetëshkrimin/CV, njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për pozitën e punës për të cilën zhvillohet konkurimi. 3.KVLBK përgatit përpara fillimit të intervistës një grup pyetjesh. Intervista që zhvillohet është e strukturuar dhe me pyetje të njëjta për të gjithë kandidatët e cila përgatitet në ditën e zhvillimit të intervistës.. 4.Vlerësimi maksimal në intervistën me gojë është njëqind (100) pike"*

Nenin 48 paragrafin 1 dhe 2, me të cilin përcaktohet se: "...Pikët e çdo anëtari për çdo vlerësim mbledhen dhe pjesëtohen me pesë. 2.Në përfundim të fazës të vlerësimit, pikët e përfituara nga secili kandidat në secilën nga hapat e vlerësimit, mbledhen dhe shuma e pikëve për të gjithë hapat e vlerësimit përbën vlerësimin përfundimtar të konkurimit".

Nenin 49 paragrafin 1, 2 dhe 3, me të cilin përcaktohet se: "1.KVLB në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, harton dhe miraton një listë me vlerësimet përfundimtare të të gjithë kandidatëve. Kandidatët renditen në listë sipas rezultatit të vlerësimit përfundimtar në rendin zbritës. Lista i dërgohet Njesisë Përgjegjëse brenda njëzetë e katër (24) orëve nga miratimi i saj. 2.Kandidati që është vlerësuar me më shumë pikë dhe që ka marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë është kandidati fitues dhe ka të drejtën të emërohet në pozitën e lirë për të cilën është zhvilluar konkurimi. 3.Nëse asnjë nga kandidatët nuk është vlerësuar me gjashtëdhjetë 60 e më shumë pikë, procedura e lëvizjes brenda kategorisë përfundon pa kandidat fitues".

Andaj bazuar në dispozitat e lartcekura si dhe duke u bazuar në shqyrtimin e provave materiale të çështjes, Kolegji i Këshillit konstaton se Njësia e Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës në pajtim me nenin 45 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës ka bërë verifikimin paraprak të kandidatëve për këtë pozitë, duke përfshirë në listën e ngushtë ankuesin si dhe kandidatët , dhe si kandidat të cilët i kanë plotësuar kushtet e përgjithshme për lëvizje brenda kategorisë si dhe kushtet për pozitën e shpallur, mirëpo sipas vlerësimit të KVBK-se asnjëri nga kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë nuk ka arritur numrin e mjaftueshëm të pikëve për përzgjedhje.

Lidhur me pretendimin se përbërja e anëtarëve të KVLBK-së ka qenë në kundërshtim me dispozitën e nenit 46 paragrafit 2 pika 2.1 e Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës me arsyetimin se asnjëri nga kandidatët e komisionit nuk kanë qenë të specializuar nga fusha e IT-së apo në shërbime logjistike, Kolegji i'u referua pikës 3-të të konkursit ku tek arsimimi i kërkuar janë përfshirë fushat nga: *Fakulteti i Teknologjisë Informativë, Ekonomik, Komunikacion Rrugor, Transport dhe Juridik*, ndërsa, bazuar në akt emërimet e anëtarëve të Komisionit rrjedh se kryesuesja e komisionit mbanë pozitën e punës Drejtoreshë e Departamentit të Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme, anëtari mbanë pozitën e punës Drejtor i Departamentit për Planifikim Strategjik dhe Çështje Ligjore, pra në vlerësimin e Kolegjit që të dy këta anëtarë plotësojnë kriterin e pozitës më të lartë se pozita e cila është rekrutuar dhe kriterin e specializimit në fushat sipas kërkesave të përgjithshme formale të kërkuara në këtë konkurs, anëtarja mbanë pozitën e punës Zyrtare e Lartë për Personel, duke përmbushur kriterin nga njësia e Burimeve Njerëzore, kurse dy anëtarët tjerë dhe mbajnë pozitën e punës Inspektorë të Punës si pozita të kategorisë profesionale, kështu që nisur nga ky fakt Kolegji i Këshillit vlerëson se përbërja e Komisionit të Vlerësimit për Lëvizjen Brenda Kategorisë i themeluar sipas Vendimit Nr.prot.553 të datës 29.03.2023, ka qenë në pajtim me dispozitat e nenit 46 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me të cilin është përcaktuar se: 1.Çdo institucion themelon Komisionin e vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë (në tekstin e mëtejme "KVLBK"). 2.KVLBK përbëhet nga: 2.1. dy (2) anëtar nëpunës civil të specializuar në fushën përkatëse për të cilin zhvillohet konkurrimi; 2.2. dy (2) anëtar, nëpunës civil të nivelit më të lartë se pozita e lirë që rekrutohet për lëvizjen brenda kategorisë të institucionit përkatës ose institucionit tjetër të shërbimit civil, njëri nga ta mbikqyrës i Drejtpërdrejtë; 2.3. një (1) përfaqësues i Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit. 3.KVLBK themelohet nga udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit, me propozim të NJBNJ. Për secilin anëtar, caktohen një anëtar kryesor dhe një anëtar zëvendësues. Anëtari zëvendësues ushtron detyrën në rastin e pamundësisë të përkohshme të anëtarit kryesor. Në rast të pamundësisë së pjesëmarrjes të Mbikqyrësi i


Drejpërdrejtë, ai zëvendësohet nga një nëpunës tjetër i të njëjtës kategori me të”, rrjedhimisht pretendimi ankimor mbi këtë bazë nuk ka mbështetje ligjore.

Përkitazi me pretendimin së KLBK-ja nuk ka bërë vlerësim të drejt të ankuesit, Kolegji i Këshillit nga shqyrtimi i shkresave të lëndës nuk ka arritur të evidentoj ndonjë parregullsi lidhur me procedurën e vlerësimit në intervistën me gojë të ankuesit, rrjedhimisht sipas vlerësimit të KLBK-së ankuesi është vlerësuar me pikë të përgjithshme prej 57.6 pikë, dhe po ashtu asnjëri nga kandidatet tjerë nuk kishte grumbulluar numrin e mjaftueshëm për emërim 60 pikë siç përcaktohet me nenin 49 paragrafi 2 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku thuhet se: *“Kandidati që është vlerësuar me më shumë pikë dhe që ka marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë është kandidati fitues dhe ka të drejtën të emërohet në pozitën e lirë për të cilën është zhvilluar konkurimi. Kandidati fitues në rastin e kandidatëve me pikë të barabarta përcaktohet, nga NJBNJ sipas nenit 27 të kësaj Rregulloreje, dispozitat e të cilit zbatohen përshtatshëm”,* ndërsa, Njësia e Burimeve Njerëzore me përfundimin e procedurës pa kandidat fitues ka vepruar në përputhje me dispozitat e nenit 49 paragrafit 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, me të cilën përcaktohet se: *“Nëse asnjë nga kandidatët nuk është vlerësuar me gjashtëdhjetë 60 e më shumë pikë, procedura e lëvizjes brenda kategorisë përfundon pa kandidat fitues”.*

Bazuar në rrethanat dhe të gjeturat si me lart, Kolegji i Këshillit konstaton se Vendimi me Nr.Prot.1021 i datës 19.04.2023 i Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë është nxjerr me vërtetim të drejtë të gjendjes faktike dhe me zbatim të drejtë të dispozitave materiale gjegjësisht dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publike dhe Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, andaj Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në mbështetje të nenit 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.766/2023.

Ardita Perçuku-Shyti

Procesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

Kryetare e Kolegjit


Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Inspektoratin e Punës dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.